



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 42

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 23 Maj 2019, në orën 11:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Naser Rugova, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Bekim Haxhiu, Drita Millaku dhe Fikrim Damka.

**Munguan:** Miljana Nikoliq, Enver Hoti, Haxhi Avdyli, Flora Brovina dhe Time Kadrijaj.

**Pjesëmarrës tjerë:** Arianit Behrami, Duresa Fata, Fatlinda Bajrami, Kuvendi i Kosovës; Mirlinda Zhushi, LDK; Urtinë Maloku, KDI; Drenushë Maxhuni, “Koha ditore” dhe mediat.

**Stafi mbështetës:** Shpresa Ramosaj-Haxhijaj, koordinatore, Greta Avdyli, praktikante.

**Mbledhjen e kryesoi:** Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

**RENDI I DITËS:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me ambasadoren e Suedisë në Kosovë, znj. Karin Hernmarck-Ahliny;**
- 3. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

- 2. Takim me ambasadoren e Suedisë në Kosovë, znj. Karin Hernmarck-Ahliny**

**Kryetarja**, fillimisht falënderoi ambasadoren e Suedisë për dëshirën e shprehur për këtë takim. Ajo u shpjegoi anëtarëve të komisionit dhe mediave se ky takim është realizuar për arsye të një bisede interaktive rreth pushimit të lehonisë dhe atij prindëror, me ç ‘rast do të paraqiten pikëpamje të ndryshme rreth këtij pushimi, si nga ana e komisionit, po ashtu edhe nga ana e ambasadores.

**Ambasadorja e Suedisë, znj. Karin Hernmarck-Ahliny**, falënderoi komisionin për mundësinë e këtij takimi. Ajo tha se ambasada tashmë është partnere me D4D (Democracy for Development) dhe së bashku po shqyrtojnë mundësitë për një sistem më modern të pushimit prindëror. Ambasada po punon në fusha të ndryshme dhe me partnerë të ndryshëm, sa i përket kësaj teme, në mënyrë që Kosova të ketë një legjislacion të pushimit prindëror, sa më efikas dhe modern. Suedia, sa i përket pushimit prindëror, është një shtet i cili është mjaft progresiv, dhe duke qenë se Kosova nuk ka resurset e duhura, nuk mund të mbërrijë në këtë shkallë të progresit të menjëhershëm. Megjithatë, ambasadorja sugjeroi që të mos shihet vetëm pjesa e resurseve, buxhetit, mirëpo Suedia të merret si shembull për mënyrën se kur dhe si ka filluar të punojë për pushimin prindëror, andaj konsideroi se duhet t’i jepet një rëndësi e veçantë qasjes dhe rrethanave të nisjes së kësaj kauze. Duke parë kështu qasjen e prindërimit dhe duke kuptuar se lindja është punë e të dy prindërve dhe nuk është vetëm një çështje e grave apo nënave, duhet punuar në mënyrë që legjislacioni të garantojë mundësinë e prindërimit të barabartë. Ajo, më pas, shpjegoi për mënyrën sesi funksionon ky ligj në Suedi, duke thënë se nëse prindërit dëshirojnë pushimin prindëror, atëherë që të dy duhet të japin kontributin e të qenurit prind. Norma legjislative e Suedisë, sot parashikon që të dy prindërit të jenë plotësisht të përkushtuar ndaj prindërimit, pa dallime. Pushimi prindëror paraqet mundësi të barabartë për të dy gjinitë, duke qenë të përfshirë në tregun e punës dhe në këtë mënyrë duke mos humbur edhe nga ana ekonomike. Arsyeja kryesore për pushim prindëror të barabartë ka rëndësi edhe për tregun e punës, sepse në qoftë se një grua ka dilemë mes asaj se duhet të studiojë dhe në të njëjtën kohë do që të ketë fëmijë, atëherë automatikisht kjo e bën atë më pak të kërkueshme në tregun e punës.

**Shpend Emini**, prezantoi modelin e propozuar nga D4D (Democracy for Development), duke marrë parasysh edhe direktivat e BE-së dhe konsultimet e organizatave të shoqërisë civile dhe sindikatave. Sipas këtij modeli, pushimi prindëror del të jetë 13 muaj, ku 8 muaj i takojnë nënës, ndërsa 5 muaj babait. Për nënën, 4 muaj parashihet të jenë me pagesë, me 70% nga punëdhënësi, 2 muaj me 50% nga paga mesatare e shtetit dhe 2 muaj pa pagesë. Ndërsa, për lejen e atësisë, parashihet 1 muaj me pagesë, me 70% nga punëdhënësi dhe leja prindërore e cila zgjat 4 muaj, ku 2 muaj paguhen me 50% nga paga mesatare e shtetit dhe 2 muaj pa pagesë. Sipas këtij modeli, do të ulej dukshëm edhe kostoja buxhetore.

**Kryetarja** njoftoi ambasadoren dhe të pranishmit për fazën aktuale të projektligjit të pushimit të lehonisë, atësisë dhe pushimit prindëror. Duke pasur parasysh se komisioni e

monitoron punën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, atëherë shumë pyetje i drejtohen ministrit, për të kuptuar më shumë rreth projektligjeve. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale ka njoftuar se Projektligji për pushimin prindëror është në Qeveri dhe pritet që pas miratimit në Qeveri, më pas të procedohet në Kuvend, e më pas në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, duke u diskutuar dhe kaluar në parim dhe do të procedohet për në seancë të Kuvendit. Ajo shprehu gatishmërinë për shqyrtimin e Projektligjit të punës dhe pushimit të lehonisë, atësisë dhe atij prindëror, duke marrë kështu edhe opinione nga shoqëria civile dhe qytetarët. Ajo, më pas, i shpjegoi ambasadores për modelin aktual të pushimit të lehonisë në Kosovë, i cili në tërësi është 12 muaj.

Ligji aktual është diskriminues për gratë edhe në aspektin e tregut të punës, që si i tillë bën që meshkujt të kenë më shumë mundësi punësimi sesa gratë. Ajo shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe ndërveprim me Ambasadën e Suedisë, si dhe me organizata të tjera rreth kësaj çështjeje.

**Ambasadorja e Suedisë, znj. Karin Hernmarck-Ahliny**, potencoi se ky legjislacion duhet të analizohet nga qasja e tij dhe jo domosdoshmërisht nga buxheti. Ajo tha se Kosova nuk duhet të marrë shembull as vendet e rajonit, as ato të BE-së, mirëpo të progresojë në atë mënyrë që të jetë një shembull për vendet e tjera. Ajo, po ashtu, tha se puna që gratë bëjnë në shtëpi nuk llogaritet si punë, mirëpo kjo është e padrejtë, për shkak se ato punojnë ndoshta edhe më shumë se dikush në tregun e punës, mirëpo ajo llogaritet si punë e papaguar, prandaj nuk vlerësohet edhe aq shumë. Ajo, po ashtu, ftoi anëtarët e komisionit për ekspozitën e organizuar me foto të baballarëve suedezë dhe kosovarë.

**Fatmire Mulhaxha-Kollçaku**, bëri një analizë të modelit të dhënë nga D4D (Democracy for Development) dhe nga ai aktual, ku edhe në modelin e parashtruar mbulohen 9 muaj, me pagesë, gjë që korrespondon edhe me modelin aktual në Kosovë, mirëpo me një ndryshim të vogël, ku ndahen pushimi mes nënës dhe babait. Ajo mendon se duhet të ndërrohet komplet mendësia e shoqërisë kosovare, në mënyrë që përgjegjësia për fëmijën mos të bjerë vetëm te gruaja, por të dy prindërit të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në rritjen e fëmijës. Sipas saj, diskriminimi që i është bërë gruas është mjaft i dukshëm, sidomos në tregun e punës, pasi që më përpara punësohet një burrë dhe gruaja diskriminohet, për shkak të rolit të saj riprodhues. Ajo pyeti ambasadoren: A kanë pasur kontakte me ministrinë në fazat e grupeve punuese dhe a kanë gjetur formë bashkëpunimi me ta? Ajo tha se kjo çështje duhet të lihet brenda Ligjit të punës dhe të mos i lihet një ligji të veçantë. Ajo, në fund, parashtrroi edhe një pyetje për a ambasadoren se si Suedia e trajton çështjen e grave, të cilat nuk punojnë, sa i përket pushimit të lehonisë.

**Naser Rugova**, tha se kjo temë është e rëndësishme për shoqërinë kosovare, shoqëri e cila është në tranzicion dhe po ashtu theksoi se barazia gjinore duhet të jetësohet edhe përmes normave ligjore. Sipas tij, Ligji i punës duhet të ketë konsensus të gjerë nga punëdhënësit,

sidomos në sektorin privat. Ai shpjegoi se legjislacioni në Kosovë është cilësor, mirëpo ka probleme serioze të zbatimit të tij në praktikë. Po ashtu, ai konsideroi se përmes grupeve punuese duhet të bëhet një studim i fizibiliteti për zbatimin e probabilitetit të funksionimit të këtij ligji në praktikë. Sipas tij, edukimi dhe emancipimi prindëror do të ndikojë në prindërim të barabartë.

**Drita Millaku**, tha se është mjaft shqetësuese çështja e kompanive private për kompensimin e lehonave, jo për arsye se kompanitë pritave nuk respektojnë gratë lehona, por për shkak se nuk ka mekanizma të duhur për t'u realizuar ky kompensim. Ajo tha se duhet të punojmë më shumë për funksionimin e këtyre ligjeve në praktikë. Gjithashtu, i bëri thirrje jo vetëm Ambasadës së Suedisë, mirëpo edhe të gjitha shteteve të tjera të zhvilluara për përkrahje, në mënyrë që të ketë implementimit adekuat të ligjeve në Kosovë.

**Bekim Haxhiu**, tha se modeli i paraqitur është një model i mirë, mirëpo mund të përshtatet me rrethanat e shtetit tonë në dy elemente. Elementi i parë është që pushimi prindëror dhe pushimi i atësisë të mos jetë diskriminues, në raport me gratë, sa i përket aspektit të punësimit, ku 6 muaj duhet të paguhen nga punëdhënësi, në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti i familjes. Elementi tjetër është pagesa me 50%, që është model i barabartë dhe nuk dallon, sa i përket aspektit të dy prindërve. Ai konsideroi se model i mirë është edhe ligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, ku neni 5 për të drejtat e gruas, e cila është në dhënie gjji, përcakton dy orë pushim me pagesë, prej muajit të gjashtë deri në vitin e parë dhe prej vitit të parë deri në vitin e dytë të ketë një orë pushim me pagesë, me qëllim të favorizimit të ushqyerjes me qumësht gjiri. Ai tha se Ligji i punës dhe i lindjes nuk do të ndahen, por do të votohen në seancë, së bashku, për arsye se ndërlidhen mes vete. Më tej, theksoi se përderisa ministria nuk sjell Ligjin për pushimin e lindjes, pushimin prindëror dhe të atësisë, komisioni nuk do ta procedojë në Kuvend, Ligjin e punës, pa u bërë harmonizimi i këtyre dy ligjeve mes vete.

**Ambasadorja e Suedisë, znj. Karin Hernmarck-Ahliny**, falënderoi anëtarët e komisionit për pyetjet dhe propozimet. Ajo sqaroi se D4D (Democracy for Development), ka punuar për së afërmi me ministrinë dhe po ashtu në një takim, i cili është mbajtur në ministri, ka theksuar detajet për vendimin e Qeverisë dhe ndryshimet e mundshme në mënyrën sesi Kuvendi do ta zgjidhë këtë propozim. Sa i përket çështjes së ushqyerjes me qumësht gjiri, ambasadorja theksoi se Suedia është vend, i cili inkurajon në masë të madhe ushqyerjen me qumësht gjiri, edhe pse për arsye të ndryshme biologjike, jo të gjitha gratë mund t'i ushqejnë fëmijët e tyre përmes qumështit të gjirit. Sa i përket uljes së natalitetit, ajo theksoi se edhe pse në Suedi shumica e grave shkollohen, janë pjesë e tregut të punës dhe kanë karrierë. Kjo nuk e ndalon shtetin për rritjen e natalitetit, dhe kjo rregullohet më së miri në bazë të ligjit

të prindërimit të barabartë. Ajo sugjeroi që të mos bazohemi komplet në sistemin e Suedisë, mirëpo ta marrim si model, duke shfrytëzuar mundësitë që jep shteti ynë.

**Kryetarja** pyeti ambasadoren: A është në Suedi i ndarë Ligji i punës me Ligjin për pushim prindëror, për shkak të dilemave të ndryshme që i kemi në Kosovë, kur vjen puna për kategorinë e grave, të cilat nuk janë në punë?

**Ambasadorja e Suedisë, znj. Karin Hernmarck-Ahliny**, tha se është i ndarë, mirëpo sistemi legjislativ është krejtësisht ndryshe, duke pasur një sistem krejtësisht të ndryshëm tek e drejta për punë. Ajo theksoi se do t'u sigurojë një informacion më të detajuar, sa i përket mënyrës së funksionimit të sistemit në Suedi.

**Fatmire Mulhaxha-Kollçaku**, kërkoi sqarim sesi zgjidhet çështja e kategorisë së grave që cilat nuk janë të punësuar. Për shkak se pushimi i lindjes, prindëror dhe atësisë i takon vetëm kategorisë së punësuar, ajo kërkoi sqarim rreth fondeve të shpërndara për gratë që nuk punojnë.

**Ambasadorja e Suedisë, znj. Karin Hernmarck-Ahliny**, shpjegoi se në Suedi, në momentin kur lind fëmija, shteti paguan, mirëpo në qoftë se prindërit janë të papunë, atëherë jepet një lloj social, për t'u kujdesur për fëmijën dhe familjen.

**Kryetarja** falënderoi ambasadoren dhe anëtarët e komisionit për pjesëmarrje dhe kontribut, për këtë temë shumë të rëndësishme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

**E përgatiti:**

***Stafi mbështetës i komisionit.***

**Kryetarja e komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**